



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.753/2021**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevci kryesues, Afijete Sada -Glllogjani dhe Ferfki Xhaferi anëtar , duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtar në Kuvend Komunal ne Prishtinë Besnik Bahtiri nga Subjekti Politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, te Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), per Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvend Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Pranohen** si të bazuara apelet Anr.753/21, Anr.754/21 dhe Anr.755/21, te paraqitura nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë Besnik Bahtiri nga radhët e Subjektit Politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatin për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë Besnik Bahtiri nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re me seli në Prishtinë, në Vendvotimet: 1927E/01R, 1935E/01R dhe 1933E/01R në Komunën e Prishtinës.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Vendvotimet, te cituara si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

**A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar apelet Anr.753/21, Anr.754/21 dhe Anr.755/21 me datën 04.11.2021, nga kandidati për anëtarë në Kuvend Komunal ne Prishtinë Besnik Bahtiri nga Subjekti Politik

Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë në të cilat pretendon se në Vendvotimet 1927/01R, 1935E/01R dhe 1933E/01R në Prishtinë i janë keqpërdorur votat nga komisionerët dhe në formularë nuk i figurojnë votat e familjes se tij ashtu që pretendon se duhet të kishte më shumë vota se rezultati preliminar ku figuron se i ka 284 vota dhe për 9 vota e humb mandatin për tu zgjedhur si anëtarë i Kuvendit Komunal në Prishtinë. Apelit i ka bashkangjitur si provë 14 deklaratatë të votuesve të tij.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i bazuar**

Paneli duke vepruar konform Rregullës Nr. 02/2015 Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, përkatësisht nenit 13.2 ku parashihet se *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të apeleve, kryesuesi i panelit vendim marrës mund të vendosë ta bëjë bashkimin e apeleve që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim”* ka bashkuar apelet Anr.753/2021, Anr.754/2021 dhe Anr.755/2021 duke i trajtuar si një apel i evidentuar me Anr 753/21, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim , andaj te njëjtat i vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket vendvotimeve si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, nga se në Formularin e Rezultateve të Kandidatëve në këto vendvotime kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Prishtinë Besnik Bahtiri ka gjithsej 0 vota, ndërsa sipas deklaratave të votuesve të tij të cilët kanë votuar në qendrat e votimit 1935E/01R, 1933E/01R dhe 1927/01R nuk figurojnë këto vota, derisa sipas deklaratave të tyre ishte dashur të ishin gjithsej 19 vota, andaj PZAP nga këto arsye dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimit e lartcekura si në pikën II të dispozitivit.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilën dispozite përcaktohet se: *“Procedurat e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e*

zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje, për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**  
Anr.753/2021 më datën 05.11.2021.

**Kryesues i Panelit**  
Adnan Konushevi



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.